Kronikë

VIDEO/ Atentati në Vlorë, momenti kur Laertjad Kekaj vrapon t'u ikë ekzekutorëve! Audi kthehet e qëllon sërish

Pamjet e filmuara nga kamerat e sigurisë mund të ndihmojnë në zbardhjen e atentatit që tronditi mbrëmë qytetin e Vlorës. Gjashtë plumba kanë përshkuar trupin e Kekës, pjesa më e madhe në kokë.

■ Atentati në Vlorë/ Laertjad Kekaj u ekzekutua me 6 plumba në kokë e trup! U qëllua me kallashnikov e pistoletë me silenciator! 28 gëzhoja në vendngjarje

■ Atentati në Vlorë, Laertjad Kekaj u qëllua me pistoletë silenciator dhe kallashnikov nga 2 qitës brenda në makinë

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Gërthitës

Redaksia
10 Shtator, 14:34 | **Përditësimi: 10 Shtator, 15:27**

Share

A A

Në lagjen "28Nëntori" në Vlorë ku u ekzekutua Laertjad Kekaj ka shumë kamera sigurie dhe policia tashmë ka nisur punën për sekuestrimin e pamjeve të cilat mund të ndihmojnë në zbardhjen e dinamikës së atentatit të ndodhur mbrëmjen e 9 shtatorit por dhe të autorëve.

Një video që po qarkullon me shpejtësi mendohet se do i vijë në ndihmë grupit hetimor për të zbardhur vrasjen.

LEXO EDHE:
Me mijëra të huaj vizitojnë qytetin antik të Butrintit! Turistët e mahnitur: Vendi më i bukur në Shqipëri

Në pamjet e videos të siguruar edhe nga Report Tv shfaqen 3 persona të cilët largohen me vrap për shkak të të shtënave. Ata mund të jenë qytetarë të thjeshtë. Një i katërt, i cili besohet se është Laertjad Kekaj i plagosur, vrapon për t'u shpëtuar plumbave. Disa sekonda më vonë në video shfaqet një "Audi" me ngjyrë gri, i cili lëviz me shpejtësi në drejtimin që vrapon i plagosuri.

Disa momente më vonë, e njëjta makinë bën kthim mbrapa indietro. Këtu mendohet se e kanë riqëlluar. Disa sekonda më pas niset në të njëjtin drejtim nga u larguan personat me vrap.

Videoja në monitor ka datën 9 shtator 2023

Çfarë dimë nga atentati deri tani?
Atentati ndodhi rreth orës 21:50 minuta. Plumbat që janë qëlluar fillimisht nga "Audi ë" pranë bibliotekës "Shefqet Musarai" në Vlorë e kanë plagosur duke e rrëzuar nga motori.

Laertjad Kekaj ka ecur rreth 100-150 metra deri tek Kisha Ortodokse, por është ndjekur nga autorët. Njëri prej tyre, mendohet se personi që ka qenë në sediljen e parë të Audit, ka zbritur dhe e ka ndjekur deri në afërsi të furrës së bukës dhe e ka qëlluar sërish pranë një furre buke, për t'u siguruar që 41-vjeçari të vdiste.

Ekspertët mjeko ligjorë thanë se 6 plumba kanë përshkuar trupin e Kekës, pjesa më e madhe në kokë.

Askush nuk është i dyshuar deri më tani. Policia e Vlorës ka shoqëruar 8 persona për t'u marrë në pyetje në lidhje me ngjarjen, pjesa më e madhe e tyre dëshmitarë në vendin e ngjarjes, por burime pranë bluve bëjnë me dije se deklarimet e tyre nuk kanë ndihmuar hetuesit për zbardhjen e identitetit të autorëve. Në vendin e ngjarjes policia gjeti 28 gëzhoja kallashnikovi dhe pistolete, plumbat e 6 prej të cilëve e kapën në kokë dhe trup, të cilët rezultuan fatal.

S.G/Shqiptarja.com

TAG: Laertjad Kekaj | Vlore | vrasja e laertjad kekaj

Komento

Komente

Vlora: 10/09/2023 17:51
Ca behet kshu ne vlor para 1 muaj policia parandaloi 2 atentat dje u vra-ky, a kan lidhje ngjarjet me njera tjetren
Përgjigju

Agjenti: 10/09/2023 16:09
Bravo policia si gjithmone vazhdon e mbledh gezhojat
Përgjigju

Nari: 10/09/2023 17:30
Bravo policia si gjithmon ne drejtim te pa ditur o minister po zbardhe nje vrasje se i ke rugve te gjithe bandat ne vlore

007: 10/09/2023 17:03
Jo vetem i mbledh, por edhe i numeron.

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Mendoni se Shqipëria do të kualifikohet në Euro 2024?

PO | JO | NUK E DI

Lajme të tjera

Kultivuan kanabis në Lukovë, 2 të arrestuar, 2 në hetim dhe 1 në kërkim! VIDEO teksa kujdeseshin për lëndët narkotike
10 Shtator, 11:22



Atentati në Vlorë/ Laertjad Kekaj u ekzekutua me 6 plumba në kokë e trup! U qëllua me kallashnikov e pistoletë me silenciator! 28 gëzhoja në vendngjarje
Armand Xhelili
10 Shtator, 07:00



Atentat në Vlorë, qëllohet për vdekje nga një mjet me targa italiane 41-vjeçari! I dënuar më parë për bashkëpunim në një vrasje (EMRI)
9 Shtator, 21:53

S'ka rrugë, 200 banorë të Janjarit në Konispolit të izoluar: Prej dy vitesh s'kemi as mjek, nuk ka nga të vijë! Kryeplaku: Jemi ankuar në çdo institucion, zero përgjigjje
Limos Didani
9 Shtator, 20:49

Pëson defekt treni që transporton naftë bruto në zonën e Petroliferës në Vlorë, bllokohet hekurudha dhe rruga dytësore
9 Shtator, 18:52

I vihet sërish flaka pikës së grumbullimit të mbetjeve në Vlorë, dyshohet për zjarr të qëllimshëm
8 Shtator, 16:13

'Rindërtimi', 14 shkolla në Durrës mësim me dy turne! Në Vlorë më pak nxënës në klasë të parë dhe gjimnaz
Armand Xhelili
Aldo Mustafa
8 Shtator, 16:06

Rruga Orikum-Dukat, ARRSH: Të hënën nis puna me shtresat asfaltike, ja si devijon trafiku
8 Shtator, 15:40

Hedhja e inerteve në Butrint dhe ndërtimet pa leje në Ksamil, arrestohen 2 zyrtarë të Zonave të Mbrojtura në Vlorë! Nën hetim 3 të tjerë
7 Shtator, 20:01

Vrasja në Gjorm të Vlorës, flet kryetari i Shoqatës së të Verbërve: E pamundur që një i verbër të mund të dhunojë! Drejtësia do të thotë fjalën e fundit
7 Shtator, 19:32

'Pushimet e vjeshtës' vazhdojnë në bregdet! Operatorët turistikë: 80% e kapaciteteve të zënë në shtator! Durrësi, Vlora, Saranda në krye të hartës së turizmit
Armand Xhelili
Limos Didani
Aldo Mustafa
7 Shtator, 18:24

VIDEO/ Aksident në aksin Kardhiq – Sarandë, dy mjete përplasen dhe përfundojnë në kanal! Një i plagosur
7 Shtator, 08:06

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje